



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA KRUIJË  
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Krujë , më 23.10.2024

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË**

**ME**  
**OBJEKT**

**“SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS BILAJ (LLIXHA)-MURQINË”, NJ.A.BUBQ,  
KRUIJË”**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me date 23.10.2024 ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit e Prokurimit caktuar me urdherin rne urdherin nr.459, date 21.10.2024 me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar” dhe ne referim shkreses se DPZHT qe mban nr.6897prot date 21.10.2024 , per proceduren e prokurimit me te dhenat si vijon:

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Sistemim-asfaltim i rrugës së Micjone , fshati Borizane , Nj.a.Thumane , Krujë”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Pune Ndertimi / (45000000-7)**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** , 9’955’969 (nente milion e nenteqind e pesedhete e pese mije e nenteqind e gjashtedhete e nente) leke pa t.v.sh

**BURIMI I FINACIMIT:**Te ardhurat e Bashkise Kruje.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kruje** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (ne masen prej 2 % te vleres te fondit limit sipas nenit 83 te Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik")

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2024 të njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesiperme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2024 për secilin operator)

**Shenim-**Per të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2024 të leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesiperme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2024 për secilin operator). **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

## 2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

b): Ofertuesi duhet të paraqesi licencën profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të leshuar nga Ministria Përgjegjëse për Infrastruktura ose Autoriteti Kompetent

- **Shoqëria ofertuese duhet të paraqesi licencën e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin e punimeve të ndërtimit si më poshtë vijon:**
- **NP-1/A**→ Punime gjurmimi në tokë.
- **-NP-4/A**→ Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- **-NS-6/A**→ Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese.
- **-NS-18/A**→ Punime topogjeodezike.

**Shenim-**Licensa duhet të jete leshuar në përputhje me kërkesat e VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar me VKM nr. 92 datë 19.02.2014.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktura, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008 ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP.1	<b><i>Punime gërmimi në tokë</i></b>	Kjo pikë kategorie është vendosur për kryerjen e punimeve të gërmimit, sipas zërit nr. 1, 2, 3 të preventivit..	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NP.4	<b><i>Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.</i></b>	Kjo pikë kategorie është vendosur për kryerjen e punimeve rrugore, sipas zërit nr. 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 të preventivit.	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NS.6	<b><i>Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese.</i></b>	<i>Kjo pikë kategorie është vendosur për kryerjen e punimeve të sinjalistikës rrugore, sipas zërit nr. 15, 16, 17, 18, 19, 20 të preventivit.</i>	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
N.S.18	<b><i>Punime topogjeodezike.</i></b>	Kjo pikë kategorie është vendosur për kryerjen e punimeve topogjeodezike, sipas të gjithë zërave 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 të punimeve rrugore të preventivit..	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**Per te provuar permbushjen kritereve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :**

**1-** Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2021,2022,2023 ) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

**Shenim-**Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.c dhe 55.4** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nen kufirin e ulet monetar dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operatoreve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

**2.)** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet financiare (2021,2022,2023), të certifikuara nga autoritetet përkatëse kompetente (Drejtoret Rajonale te Tatimeve) , që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

**Shenim:** Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse ne treguesit e bilanceve per dy vite te njepasneshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", Ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 "*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*", si dhe parashikimve të Nenit 57 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008"*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", Ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike"

**Teresia e kritereve që i perkasin kapacitetit teknik si pjese integrale e kritereve të vecanta është hartuar nga struktura e DPZHT dhe janë percjelle në NJ.P.P me shkresën nr. 6897 Prot Date 21.10.2024 .**

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

##### **2.3.1-Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:**

##### **2.3.1-Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:**

1-a-Operatorët ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshtë në ekzekutimin e kontratave:

a) punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 (pese) viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5 (pese) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se vlera e dyfishit të fondit limit të kontratës që prokurohet .

**Shenim- Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme**

c) Pika "2.3.1/a" plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika "2.3.1/b" duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

d) Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

i- Per punimet e kryera në sektorin publik duhet të paraqiten dokumentacioni provues si vijon:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 09, shoqëruar me:



- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përfundimtare të deklaruara në organet tatimore
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

ii-Ndërsa në rastin e parësor se mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtem:

- Kontraten e sipërmarrjes
- Situacionin përfundimtar
- Akt kolaudimit
- Çertifikatën e marrjes në dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- Faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore

(Elementet provues të mesiperm janë kërkuar në referim të legjislacionit përkatës në fuqi për disiplinimin e kontrollin e punimeve të ndërtimit e me konkretisht në referencat e dispozitave të Ligjit Nr.8402, Datë 10.9.1998 ‘‘Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit’’ i ndryshuar ,dhe VKM nr 408 datë Nr. 408, datë 13.5.2015’’ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit’’ i ndryshuar.)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ‘‘Për prokurimin publik’’ dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat., 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me të vogël se vlera e fondit limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Marzhi i mesiperm është konsideruar i tillë që parë në aspektin e ofertimit iu jep mundësi dhe akses pjesëmarrje në konkurim edhe subjekteve ofertues të cilët janë biznese të vegjël ose të mesëm duke zgjeruar hapësirën e ofertimit.

**2.3.3-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin një vetedeklarim (leshuar nga administratori i shoqërisë ofertuese) që brenda të njëjtes periudhe nuk është kontraktor/nenkontraktor për kontratë /apo kontrata të lidhura me vlerë të përbashkët ose të vecantë jo më e madhe se 100% i kufirit maksimal që disponon kandidati sipas licenses profesionale , të leshuar nga autoriteti kompetent .**

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 26 pika 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ‘‘Për prokurimin publik’’, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për

*miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, i ndryshuar .*

2.3.3-a).Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, staf inxhinierik si më poshtë për të cilin duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme(me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit të shërbimit për këtë objekt), diploma dhe CV.

-Inxhinier Ndërtimi/ rruga ura/ transporti →**1 inxhinier.**

-Inxhinier Gjedodet/Topograf →**1 inxhinier.**

**Shënim-** Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit **Shënim-** Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. **285, datë 19.5.2021** , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një afat **kohor prej 52 (pesëdhjetë e dy) dite** i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Kapaciteti për fuqi punëtore inxhinierike për stafin e kerkuar inxhinierik bazohet në K.Punës, dhe në V.K.M. nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar dhe lidhet ngushtësisht me nevojën për realizimin në kohë të kontratës duke iu referuar zbatimit të punimeve, si dhe në përputhje me zërat dhe volumet e punimeve të preventivit sipas projektit të zbatimit.Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

**-Inxhinier ndërtimi/ rruga ura/ transporti →1 inxhinier (minimumi) për ndjekjen dhe zbatimin e punimeve ndërtimore e rrugore, sipas zërave të preventivit.**

**-Inxhinier gjeodet/ topograf →1 inxhinier/topograf (minimumi) për ndjekjen dhe zbatimin e punimeve topografike, dhënien dhe kontrollin e kuotave topografike sipas zërave të preventivit.**

### **2.3-5-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik**



a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **4 (kater ) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerve të rënda, (specifikisht **1(nje)** manovrator për asfaltoshtruese, **1(nje)** manovrator për eskavator dhe **2 (dy)** manovrator për rrul vibruës/grejderi).

b) Për çdo profil punonjeshi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (përgjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës) dhe dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente përkatëse sipas modaliteteve përkatëse.

**Shenim-** Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Gjithashtu për profilin e manovratorëve është marrë në konsideratë drejtpërdrejtë natyra e zerit të punimeve përkatëse të cilët mund të zbatohen vetëm nëpërmjet proceseve të mjeteve e makinerve të vecanta ose të rënda të cilat janë kërkesë funksionale e realizimit të zerave të punimeve.

#### **2.3.4. Personeli dhe fuqia punëtore:**

- Kandidati/ofertues duhet të vertetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për ekzekutimin e kontratës dhe për të provuar këto kusht duhet të ketë një punësim mesatar personeli për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, i të pakten 20 (njëzet) personave duke përfshirë stafin e përhershëm (teknik , të kualifikuar e administrativ) të provuar me
- Vertetim të lëshuar nga Dega e Tatimeve të Qarkut ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të qarkut përkatës .

#### **ose**

- Listepagesat për periudhën e mesipërme (E-sig 025) sipas formatit elektronik në përputhje me VKM nr 922 datë 29.12.2014” **Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”**

**Shenim-** Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje

me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje 3 (tre ) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri/garanci për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje 3 (tre ) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për njëpunësim të paktën **20(njzet ) persona** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

**6.-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

<b>I.MAKINERI</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Pronësia</b>
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Kamionçinë nën 3.5 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Eskavator.	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshës i tonazhit të madh.	copë	1	Pronësi ose me qera
Grejder.	copë	1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe.	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul asfalti.	copë	1	Pronësi ose me qera
<b>II.PAJISJE</b>			
Betonierë.	copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator (betoni).	copë	1	Pronësi ose me qera
Jelekë fosforeshentë/uniforma pune.	copë	20	Pronësi ose me qera
Kallëp dërrase.(armaturë).	m2	120	Pronësi ose me qera
Karroca dore.	copë	1	Pronësi ose me qera

Tabela rrugore (për punime në rrugë).	copë	4	Pronësi ose me qera
Kokore për punonjësit.	copë	20	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatëse (e vlefshme).*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 08.pika C (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*

**Shenim-** Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar zerave respektiv te punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në analiza të mbeshetur ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në fuqi për disiplinimin e punimeve të ndërtimit. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

- Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga subjekti i licensuar që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qenë elemente perberes të tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsiderat kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

- Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive., ato jane percjelle prane NJPP nepermjet shkreses se DPZHT me nr. 6897 Prot date 21.10.2024 .
- **Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar nga ana e projektuesit respektiv ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015** ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'' i ndryshuar.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK**

**Eglantina Subashi      Melisa Kupa      Mikeda Caca**